

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	III
Semestri:	VI
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ofron një kuptim të thellë mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), rolin e tyre në ekonomi dhe menaxhimin efektiv të tyre. Studentët do të mësojnë për strukturat organizative, strategjitë e menaxhimit, financimin, marketingun dhe inovacionin në NVM. Një fokus i veçantë do të jetë në studime rasti të ndërmarrjeve të suksesshme dhe të dështuara, si dhe në zhvillimin e planeve të biznesit, duke u dhënë studentëve aftësi praktike për menaxhimin dhe rritjen e një ndërmarrjeje.
Qëllimet e lëndës	Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e NVM-ve në ekonomi. Të analizojnë sfidat menaxheriale dhe operacionale të NVM-ve. Të zhvillojnë aftësi praktike përmes studimeve të rastit dhe planeve të biznesit. Të aplikojnë njohuritë teorike në zgjidhjen e problemeve reale të biznesit.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Përfitojnë njohuri mbi rolin dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në ekonomi, (ECTS: 1) 2. Analizojnë strukturat organizative, sfidat dhe mundësitë e NVM-ve, (ECTS: 0.5) 3. Ndërtojnë aftësi për zhvillimin dhe vlerësimin e planeve të biznesit në kontekstin e NVM-ve, (ECTS: 0.5) 4. Shfrytëzojnë njohuritë teorike për të interpretuar dhe zgjidhur studime rasti të ndërmarrjeve të suksesshme dhe të dështuara, (ECTS: 1) 5. Informohen për ndikimin e transformimit dixhital dhe Inteligjencës Artificiale në menaxhimin dhe zhvillimin e NVM-ve, (ECTS: 0.5) 6. Të jenë kompetentë për të marrë pjesë në punë ekipore dhe projekte praktike në kuadër të menaxhimit të NVM-ve, (ECTS: 0.5)
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet			
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)			
Detyra të shtëpisë	1	8	8
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			27
Përgatitja përfundimtare në provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjëratat do të zhvillohen me studentin në qendër, duke kombinuar mësimdhënie teorike dhe praktike. Do të përdoren ligjërata, ushtrime, shembuj praktikë, punime seminarike, studime rastesh dhe vlerësime periodike. Materialet do të prezantohen në formë audio-vizuale përmes programeve të Windows Office. Mësimi do të jetë interaktiv, me diskutime në grup dhe prezantime, duke nxitur aplikimin praktik të njohurive dhe angazhimin e studentëve.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminarik.....max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 80 pikë (%), <u>Kriteret e kalueshmërisë:</u> 1.Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – maksimumi 10 pikë (%) Aktiviteti në mësim (10 pikë): studenti merr pjesë aktive në diskutime interaktive profesor–student dhe student–student, propozon ide dhe analizime kritike të lidhura me ndërmarrësinë dhe inovacionin, dhe kontribuon në zhvillimin e debatit gjatë ligjëratave. Studenti kryen dhe prezanton detyrat dhe ushtrimet e dhëna gjatë ligjëratave, duke demonstruar aftësi analitike dhe mendim kritik. Qëllimi: të nxisë mendimin kritik dhe zgjidhjen kreative të situatave praktike në kontekstin e lëndës. 2.Hartimi dhe prezantimi i projektit/punimit seminaror – maksimumi 10 pikë (%) Studentët, individualisht ose në grupe deri në 2 studentë, përgatitin një projekt ose punim seminaror në Word dhe PowerPoint mbi një temë të miratuar nga profesori, e cila duhet të jetë plotësisht e lidhur me lëndën. Prezantimi kryhet gjatë orëve të caktuara dhe zgjasin maksimumi 15 minuta.		

	Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari																														
	Komponenti			Pikët (%)																											
	Struktura dhe Qëllimi i punimit			3																											
	Përmbajtja/shtjellimi i punimit			4																											
	Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit			3																											
	Gjithsej:			10																											
	Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe prezantuese, si dhe aftësia për të trajtuar akademikisht një temë të caktuar..																														
	3.Provimi final – maksimumi 80 pikë (%)																														
	Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 40 pikë (%))																														
	Struktura e provimit final:																														
	Pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta: 30 pikë (%) – për të vlerësuar njohuritë bazë dhe rikujtimin e koncepteve të lëndës.																														
	Pyetje subjektive/tematike: 50 pikë (%) – për të vlerësuar aftësinë e studentit për të kuptuar, analizuar dhe aplikuar njohuritë e fituara në situata reale.																														
	Qëllimi: vlerësimi i përvetësimit të rezultateve të të nxënës dhe aftësisë për t'i aplikuar ato në situata praktike të ndërmarrësisë dhe inovacionit.																														
	Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,																														
	Notat në UShAF:																														
	<table><tr><td>Nota</td><td>ECTS/Nota</td><td>Përqindja (%)</td><td>Përkufizimi</td></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>				Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																												
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																												
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																												
8	C	70 - 79	Shumë mirë																												
7	D	60 - 69	Mirë																												
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																												
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																												
Mjetet e konkretizimit – TI																															
Përdorimi i Smart-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																															
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit																															
70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. 70 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. 30 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS sipas raportit 70%-30%																															

	❖ 3 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.
Literatura	
Literatura bazë	1. M.Mustafa, E.Kutllovci, B.Krasniqi -Biznesi i Vogël dhe i Mesëm; Botuar në 2006; Riinvest 2. Arta Jashari- Goga- Lgjerata te autorizuaera – Ndermarrjet e vogla dhe te mesme 2025
Literatura shitesë	1. Ilan Bijaoui, 2017, SMEs in an Era of Globalization: International Business and Market Strategies
<i>Informacion shitesë</i> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	Punimi Shkencor -. nga autoret: Arta Jashari & Enver Kutllovci 2020. Titull – “The impact of human resource management practices on organizational performance case study: manufacturing enterprises in Kosovo” I botuar ne Revisten shkencore Business: Theory and Practice 21 (1), 222-229” Linku i punimit: https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=951060
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Diskutim me studentet për lëndën, për literaturën, për materialin shitesë, për aktivitetet e parapara gjatë ligjëratave, marrja e informatave kthyes nga studentët, etj. Hyrje në lëndë – Koncepti i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, definicionet dhe kriteret e klasifikimit (BE, OECD, Kosova). Rezultati i pritur 1
Java e dytë	Roli i NVM-ve në ekonomi Analizimi i ndikimit të NVM-ve në zhvillimin ekonomik, punësim, inovacion dhe konkurrueshmëri. Diskutim mbi rolin e tyre në tregjet lokale dhe globale. Rezultati i pritur 2
Java e tretë	Karakteristikat kryesore të NVM-ve Përparësitë dhe dobësitë e NVM-ve. Fleksibiliteti, dinamika, por edhe sfidat strukturore dhe burimore. Rezultati i pritur 1 dhe 2
Java e katërt	Menaxhimi strategjik në NVM Procesi i planifikimit strategjik: vizioni, misioni, objektivat. Si i përshtatin NVM-të strategjitë në kushte konkurrence Rezultati i pritur 1 dhe 2
Java e pestë	Strukturat organizative dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në NVM. Format organizative në NVM. Rekrutimi, motivimi, trajnimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në kushte të kufizuara. Rezultati i pritur 1 dhe 3
Java e gjashtë	Financimi i NVM-ve Burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit. Sfidat për sigurimin e kapitalit dhe qasja në kredi/grante.

	Rezultati i pritur nr. 2.
Java e shtatë	Testi 1 (përmbledhja e kapitujve 1–6).
Java e tetë	Marketingu në NVM Strategjitë e marketingut për ndërmarrjet e vogla. Pozicionimi i markës, menaxhimi i klientelës dhe përdorimi i kanaleve digjitale. Rezultati i pritur 1 dhe 2
Java e nëntë	Inovacioni dhe teknologjia në NVM Transformimi digjital. Roli i inovacionit në rritjen e NVM-ve. Transformimi digjital si mjet për rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë 1 dhe 3
Java e dhjetë	Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në menaxhimin financiar dhe vendimmarrjen e NVM-ve. Si IA po ndihmon NVM-të në analizën e të dhënave, menaxhimin financiar dhe përmirësimin e vendimmarrjes. Shembuj praktikë. Rezultati i pritur 1 dhe 5
Java e njëmbëdhjetë	Mjedisi ligjor, fiskal dhe rregullator i NVM-ve. Ligjet dhe politikat që ndikojnë tek NVM-të. Taksat, procedurat fiskale dhe mbështetja institucionale. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e dymbëdhjetë	Aplikimet e Inteligjencës Artificiale në marketingun dhe menaxhimin e klientelës në NVM. Përdorimi i IA për segmentimin e tregut, personalizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e përvojës së klientit në NVM. Rezultati i pritur nr. 4 dhe 5
Java e trembëdhjetë	Zhvillimi i planeve të biznesit – elementët kryesorë dhe praktika. Struktura e planit të biznesit: analiza e tregut, strategjia, financat, menaxhimi i rrezeve. Ushtrime praktike mbi hartimin e planeve. Rezultati i pritur nr. 6
Java e katërbëdhjetë	Testi 2 (përmbledhja e kapitujve 8–13).
Java e pesëmbëdhjetë	Prezantime të studentëve studime rasti, plane biznesi dhe diskutim i përgjithshëm. Rezultati i pritur nr. 6
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	